



Referenca e detyrës: Ekspert/e për ngritje te kapaciteteve avokuese e buxhetore dhe zhvillimin e planeve të veprimit mjedisor në shkollë me shtatë Eko-klubet në shkollat emesme të ulëta në komunat Pejë dhe Junik.

Referenca e Projektit: Aksioni për Ndryshimet Klimatike dhe Mbështetja e Mjedisit në Kosovën Perëndimore që financohet nga Caritas-i Zviceran në kuadër të programit “ Ndikimi I Rinisë në Mjedis”YENI (Youth Environmental Impact) dhe zbatohet për regjionin perëndim nga OJQ Syri i Vizionit

Kontrata REF: 125/SiV/2024

Afati i fundit për aplikime: 04.03.2024

THIRRJE PËR EKSPERT/E

Syri i Vizionit kërkon Ekspert/e për ngritje te kapaciteteve dhe zhvillimin e planeve të veprimit mjedisor në shkollë me shtatë Eko-klubet në shkollat emesme të ulëta në Pejë dhe Junik lidhur me:

- Ngritja e aftësive dhe kapaciteteve të nxënësve për zhvillimin e planeve të veprimit në shkollë (nxënësit këshillat e nxënësve/Eko Klubett do të ndërtojnë aftësitë e tyre për të zhvilluar planin e veprimit mjedisor të shkollës);
- Mbështetje për zhvillimin e 7 planeve të veprimit mjedisor (ndihmojini nxenesit të shkruajnë plane mjedisore);
- Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i aftësi avokuese dhe lobuese në nivel lokal për planet Lokale te Veprimit ne Mjedis (PLVM);
- Ngritja e kapaciteteve në përfshirjen e veprimeve rinore dhe mjedisore në buxhetet lokale përmes PLVM të komunave Pejë dhe Junik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT

Termet e Referencës

Hyrje

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe

ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

II. Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) është duke zbatuar projektin “**Aksioni për Ndryshimet Klimatike dhe Mbështetja e Mjedisit në Kosovën Perëndimore**” i cili është i përkrahur nga Caritasi Zvicëran në kuadër të projektit “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” YENI (Youth Environmental Impact). Projekti ka për qëllim të përkrahë Eco Klubet apo Këshillat e Nxensëve nga Shkollat e Mesme në Pejë dhe Junik për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve ambientale si dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre për të dizajnuar, zhvilluar dhe realizuar aktivitetet.

Angazhimi i Syri të Vizionit do të fokusohet në pikat si më poshtë:

- (a) Funksionimi efektiv i forumit/organizatave të tyre (echo clubs dhe këshillat studentorë);
- (b) Zhvillimi i aftësive dhe kapaciteti të anëtarëve të tyre;
- (c) Zhvillimin e planeve përkatëse të veprimit dhe aktiviteteve për t'u zbatuar;
- (d) Rritja e aftësive të tyre për mbrojtjen e ndryshimeve klimatike dhe mjedisore;
- (e) Mbështetja e zhvillimit të lidhjeve dhe kuadrit të bashkëpunimit me autoritetet lokale përkatëse për të ndikuar në politika dhe vendimmarrje; dhe
- (f) ndërtojnë veprime dhe ndërhyrje lokale ndërgjegjësuëse dhe komunikuese.

III. Objektiva

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një trajnerë/e profesionist/e me përvojë (së paku pesëvjeçare) në punën dhe fuqizimin e nxënësve dhe shkollave në fushën e mjedisit si në vijim: fuqizimin e këshillave të nxënësve në hartimin e planeve të veprimit për ndikim në mjedis brenda shkollës përkrahjen në zbatimin e projektit në fushat si në vijim:

1. Ngritja e aftësive dhe kapaciteteve të nxënësve për zhvillimin e planeve të veprimit në shkollë (nxënësit këshillat e nxënësve/echo club-et do të ndërtojnë aftësitë e tyre për të zhvilluar planin e veprimit mjedisor të shkollës)
2. Mbështetje për zhvillimin e 7planeve të veprimit mjedisor (përkrah nxënësit të shkruajnë plane mjedisore)
3. Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i aftësi avokuese dhe lobuese në nivel lokal;
4. Ngritja e kapaciteteve në përfshirjen e veprimeve rinore dhe mjedisore në buxhetet lokale të komunave Pejë dhe Junik(përditësimi i planeve lokale të veprimit mjedisor me kontributet e ekoklubeve).

Këto plane që do të hartohet nga vetë nxënësit/ekoklubet do të shërbejnë jo vetëm për zhvillimin e politikave shkollore në fushën e mjedisit dhe parandalimin e ndryshimeve klimatike, por edhe do të inkorporohen edhe në Planin e ri për të Veprimit për Ndikim në Mjedis në komunën e Pejës dhe Junikut.

Nga këto aktivitete do të përfitojnë rreth 50 nxënës nga Peja dhe Juniku si dhe do të mundësohet të rriten kapacitetet e tyre rreth zhvillimit të planeve të veprimit për mjedisin dhe intervenimet e deritanishme në këto shkolla të jenë të qëndrueshme përmes veprimeve që do të ndërmerren edhe vitet në vijim.

IV. Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë Universitare (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në fushën e mjedisit, Ekologjisë , biologjisë apo të ngjashme është përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së trajnimeve/punës në mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike (ngritje të kapaciteteve, zhvillimi i planeve të punës me nxënës dhe të rinj në shkolla, avokim për fushën e mjedisit në politika lokale e nacionale dhe organizata joqeveritare);
- Njohuri të mira mbi strategjitë nacionale e lokale dhe legjislacionin në fuqi për fushën e mjedisit;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, komunikim miqësorë dhe të kuptueshëm për nxënësit/ekoklubet;;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.

V. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Nga trajneri/ja i/e angazhuar pritet të:

- Zhvilloj materialet e trajnimeve sipas projekt propozimit në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it;
- Mbanë dy trajnime me nxënësit/ekoklubet;
- Mbanë dy punëtori për zhvillimin/shkrimin e planeve mjedisore për secilën shkollë;
- Harton koncept dokumentin me planet e veprimit për secilën shkollë në bashkëpunim me nxënësit/eko klubet.

VI. Angazhimi i Ekspertit/es:

Trajneri/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit- nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet prej 30 ditë punë gjatë muajit mar-prill 2024.

Detyrat	Kohëzgjatja
Përgatitja e materialeve për trajnim	1 ditë
Mbajtja e trajnimeve me nxënës/ekoklube	2 ditë
Mbajtja e punëtorive për zhvillimin e planeve mjedisore në shkollë	2 ditë
Mbështetja e nxënësve/ekoklubeve në finalizimin e planeve të veprimit në shkollë	1 ditë
Mbajtja e trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve dhe fuqizimi i aftësi avokuese dhe lobuese në nivel lokal	2 ditë
Mbajtja e punëtorive për përfshirjen e veprimeve rinore dhe mjedisore në buxhetet lokale të komunave Pejë dhe Junik	2 ditë
Gjithsej:	10 ditë

VII. Kushtet e Pagesës:

Pagesa e këshilltarit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të përgatitet nga SiV e do nënshkruhet nga Këshilltari/ja. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro. Pagesa do të bëhet në disa këste pas kryerjes së aktiveteve dhe dorëzimit të faturave.

Në bazë të ligjit të Kosovës, Syri i Vizionit është po ashtu i obliguar që të paguajë tatimin (taksa dhe Pension) bazuar në ligj për të ardhurat personale në Kosovë

VIII. Dokumentet e kërkuara dhe procedura për aplikim:

1. Diplomën Universitare dhe ndonjë Certificate licencimi të fushës përkatëse;
2. Metodologjinë e punës në mbajtjen e trajnimeve dhe punëtorive të përcaktuara me ToR;
3. Letër për Shprehje të Interesit për këtë angazhim;
4. Planin tentativë të punës duke ju referu kritereve të angazhimit kohor sipas pikës VI;
5. Biografia - CV e personelit që do të jenë të angazhuar;
6. Propozimi financiar*

**Oferta financiare duhet të jetë e hollësishme për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë, materialet e trajnimeve dhe punëtorive.*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syrivizionit.org ose naser.lajqi@syrivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për Mbajtjen e Trajnimeve me nxënës/ekoklube ne Pejë dhe Junik. Aplikacionet mund të dorëzohen edhe fizikisht përmes postës në adresën "OJQ Syri i Vizionit", rr. Isa Demaj, nr. 14, 30 000-Pejë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 04 Mars 2023, ora 16:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!